



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të përcaktuara me nenin 16 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, gjegjësisht nenin 39 të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe neneve 3.1 dhe 3.3 të Rregullës Zgjedhore 12/2013 Kufizimi i shpenzimeve të fushatës dhe deklarimi financiar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me date 11.02.2020, merr këtë:

VENDIM

për kufizimin e shpenzimeve të fushatës për subjektet politike për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës

- I. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përcakton kufirin e sipërm të shpenzimeve të fushatës për subjektet politike për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës që do të mbahen me datë 15 mars 2020, në shumën prej 43,433 € (dyzet e tremijë e katërqind e tridhjetë e tre euro).
- II. Neni 3.1 i Rregullës Zgjedhore nr. 12/2013 shpreh që kufizimi i shpenzimeve të fushatës dhe deklarimi financiar, parasheh që kufizimi i shpenzimeve të fushatës për do të jete 0.5 euro për votues të regjistruar. Numri i votuesve sipas listës preliminare të regjistrimit civil në Republikën e Kosovës është 86,866 (tetëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) votues të regjistruar.
- III. Shpenzimet maksimale për fushatë nga pika 1 e këtij vendimi zbatohen për çdo mall dhe shërbim të shpenzuar për qëllimet e fushatës, pa marre parasysh kohen e blerjes së shërbimeve.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

ALIM RAMA

[Signature]

Valdete Daka, Kryetare